

SHPLLJE VENDI VAKANT PËR 9 POZICIONE SPECIALIST KAPITENERIE (I PËRKOHSHËM Prill-Shtator) DHE NJË POZICION SPECIALIST PER SIGURINE DETARE (I PËRKOHSHËM Prill-Shtator)

SHPLLJE VENDI VAKANT PER VITIN 2022 PËR 9 POZICIONE SPECIALIST KAPITENERIE (I PËRKOHSHËM) PER KOMAN, POGRADEC, HIMARE, VLORE, SARANDE, DURRES DHE NJË POZICION SPECIALIST PER SIGURINE DETARE (I PËRKOHSHËM) DURRES

Në zbatim të Ligjit Nr. 10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë” dhe të VKM-së nr. 35, datë 19.01.2022, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”; Drejtoria e Pergjithshme Detare;

- **Shpall 9 (nente) vende vakant për pozicionin “Specialist Kapitenerie”, me kontratë të përkohshme (Prill-Shtator)**, në mbështetje të VKM-së nr35, datë 19.01.2022, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”;
- **Shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin “Specialist per Sigurine Detare”, me kontratë të përkohshme**, në mbështetje të VKM-së nr. 35, datë 19.01.2022, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021 (Maj-Shtator) në njësitë e qeverisjes qendrore”;

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT PËR “SPECIALIST KAPITENERIE”, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME:

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Navigacion/Menaxhim Detar/Inxhinjeri Navale.
- Preferohen të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.
- Preferohen te kene trajnime ne fushen e detarise

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT PËR “SPECIALIST PER SIGURINE DETARE” ME KONTRATË TË PËRKOHSHME”:

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Navigacion/Informatike /. □ Preferohen të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.
- Preferohen te kene trajnime ne fushen e detarise/informatikes

- Marrëdhënia e punës me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për këto pozicione rregullohet nga dispozitat e ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe në mbështetje të VKM-së nr. 35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup.
- Kategoria e pagës për pozicionin e **“Specialist Kapitenerie”, dhe “Specialist për Sigurinë Detare”** është “Kategoria IV-b”,
- Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:
 1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
 2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
 3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
 4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 5. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 25 Mars 2022 pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në adresën: Rruga Tregtare, Lagja nr.1, Durrës, Zyra e Protokollit.